



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:190545

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06234203

CN.nr.202/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesionale H.D. në çështje juridike jokontestimore të propozuesve B.K.1., A.K., Sh.K. dhe B.K.2. të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson S.R. avokat nga Prizreni, të paraqitur ndaj kundërpropozuesve Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës I..... SH.A, me seli në Fushë Kosovë, dhe Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore e Komunës V.I.Xh. me objekt të çështjes caktimi i kompensimit, jashtë seancës gjyqësore me datën 01.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si i palejuar propozimi i propozuesve B.K.1., A.K., Sh.K. dhe B.K.2 të gjithë nga Prizreni, të paraqitur ndaj kundërpropozuesve Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës I..... SH.A, me seli në Fushë Kosovë dhe Komuna e Prizrenit, me objekt të çështjes caktimi i kompensimit, pasi propozimi është paraqitur nga personi i pa autorizuar si veprim i parë i ndërmarrë procedural.

A r s y e t i m

Propozuesit B.K.1., A.K., Sh.K. dhe B.K.2 të gjithë nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur propozim ndaj kundërpropozuesve Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës I..... SH.A, me seli në Fushë Kosovë, dhe Komuna e Prizrenit, me objekt të çështjes caktimi i kompensimit.

Propozimin e paraqitur e ka nënshluar avokat S.R. nga Prizreni, mirëpo propozimit nuk i është bashkangjitur autorizimi i përfaqësuesit të propozuesve. Andaj për këtë arsye, gjykata me Aktvendimin me shenjë CN.nr.202/2024, të datës 20.09.2024, në kuptim të dispozitës së nenit 93 par.1 dhe 4 të LPK-së, e lidhur me nenin 3 të LPJK-së, i ka ftuar propozuesit B.K.1., A.K., Sh.K. dhe B.K.2 të gjithë nga Prizreni, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi propozimit të ia bashkëngjisin autorizimin për avokatin S.R. nga Prizreni, ndërsa

në pikën II të këtij aktvendimi është njoftuar për pasojat në rast të mos veprimi sipas këtij aktvendimi.

Gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas propozimit të propozuesve për shkak se propozuesit brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e kanë paraqitur autorizim për avokat Salim Rexha nga Prizreni, e në mbështetje të nenit 93 par.3 të LPK-së, ku thuhet se “...Në qoftë se ky afat kalon pa sukses, gjykata do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi pa prokurë...” dhe nenit 390 të LPK-së, parashihet që: “Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji)”, e lidhur me nenin 3 të LPJK-së, në të cilin parashihet: “Në procedurën jokontestimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe”.

Gjykata konstaton se propozimi i paraqitur nga avokat S.R. nga Prizreni, është iniciuar nga personi i pa autorizuar dhe i njëjti në afatin e caktuar nga gjykata nuk e ka prezantuar autorizimin e palës propozuese, ndërsa që në shkresat e kësaj lënde nuk ekzistojnë provat që i njëjti të ketë vepruar konform këtij vendimi. Mbi këto rrethana gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet për të vepruar në kuptim të nenit 93.3 të LPK-së, për të anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë dhe rrjedhimisht për të hedhur poshtë propozimin si veprim i parë i ndërmarrë procedural.

Në bazë lartcekurave në kuptim të nenit 102.3, lidhur me neni 93.3, dhe 390 të LPK-së, lidhur me nenin 3 të LPJK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
CN.nr.202/2014, datë 01.10.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.